

**RREGULLORE PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT TË MBROJTJES SË
TË DHËNAVE PERSONALE TË INSTITUCIONIT KOMBËTAR
KINOTEKA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	3
2. Rolet dhe përgjegjësitë	5
3. Raste kur VNMDHP kryhet detyrimisht	5
4. Raste kur VNMDHP nuk është e detyrueshme	7
5. Procesi i kryerjes së vlerësimit të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave personale.....	8
6. Vlerësimi	11
7. Shtojca 1 – Vlerësimi fillestarë i ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale.....	13
8. Shtojca 2 – Zbatimi i VNMDHP	15

Në bazë të Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale (Gazeta Zyrtare nr. 42/20) neni 39 dhe Rregullores përkatëse për procesin e vlerësimit të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale (Gazeta Zyrtare nr. 122/2020), IK Kinoteka e Republikës së Maqedonisë së Veriut më _____ miratoi

DRAFT RREGULLORE PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE NË IK KINOTEKA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

1. Hyrje

Në bazë të nenit 39 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare nr. nr. 42/20) IK Kinoteka e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: Kinoteka) si kontrollues, është i obliguar të vlerësojë ndikimin e mbrojtjes së të dhënave personale (në tekstin e mëtejme VNMDHP), në rastet kur përpunimi i të dhënave personale mund të rezultojë në rrezik të lartë për liritë dhe të drejtat e personave fizik.

Vlerësimi i ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale është plotësim i ri në kornizën ligjore evropiane për mbrojtjen e të dhënave personale dhe kjo duhet detyrimisht të kryhet në përputhje me ***Rregulloren për procesin e vlerësimit të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale***, në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili hyri në fuqi më 16.02.2020.

Vlerësimi i ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale kryhet me qëllim të identifikimit me kohë të të gjitha rreziqeve të mundshme që mund të lindin nga operacione të caktuara që përpunojnë kategori të ndjeshme të të dhënave personale.

VNMDHP është një vegël që lehtëson vendimmarrjen në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, dhe në veçanti në lidhje me zbatimin e masave teknike dhe organizative që do të sigurojnë respektimin e të drejtave dhe lirive të personave fizik. Ne si kontrollues mbajmë të gjithë përgjegjësinë në procesin e kryerjes së Vlerësimit edhe përkundër faktit që në proces mund të përfshihen edhe përpunuesit. Në këtë kuptim, si përgjegjës për përpunimin e VNMDHP përcaktohen pronarët e të dhënave (përgjithësisht, drejtuesit e njërive organizative që mbledhin të dhënat personale), si dhe bartësit e përpunimit konkret të të dhënave personale.

Nëse VNMDHP kryhet si pjesë e një projekti, menaxheri i projektit është përgjegjës të konsultohet me zyrtarin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe në fazën fillestare të projektit të fillojë përgatitjen e VNMDHP së bashku me pronarët e të dhënave dhe bartësit e përpunimit konkret.

VNMDHP synon të përcaktojë qasjen dhe parimet që do të përdoren për kryerjen e vlerësimit përmes:

- Identifikimit dhe përshkrimit të operacioneve të kontrolluesi në të cilat përpunohen të dhënat personale që mund të rezultojnë në rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e personave fizik
- Vlerësimit të domosdoshmërisë së përpunimit të të dhënave personale (për çfarë qëllimi kontrolluesi kryen atë përpunim)
- Analizës së rreziqeve të mundshme që mund të lindin nga përpunimi dhe që do të kishin ndikim të dëmshëm ndaj subjektit nëse ajo kategori e të dhënave personale do të zbulohet
- Miratimit të masave të përshtatshme për të zvogëluar rreziqet që do të lindin nga përpunimi i caktuar i të dhënave personale

Me realizimin e VNMDHP, ne, si kontrollues, dëshmojmë se marrim parasysh ndikimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe se jemi të gatshëm të përcaktojmë qasjen më të mirë të mundshme për të zvogëluar pasojat që mund të shkaktojnë operacione të caktuara të përpunimit të të dhënave personale mbi subjektet.

Shembuj të praktikave të mira për angazhimin e personave dhe përfshirjen e njësive organizative përkatëse në zbatimin e VNMDHP:

PRAKTIKË E MIRË	Shembull
Shqyrtimi dhe përfshirja e njësive organizative përkatëse në zbatimin e VNMDHP	Gjatë zbatimit të VNMDHP për të formuar klub besnikërie, duhet të përfshihen personat nga IT dhe siguria e sistemit të informacionit
Përfshirja e zyrtarit në zbatimin e VNMDHP	Oficeri mund të: • sugjeron kur duhet të zbatohet VNMDHP • asiston në përzgjedhjen dhe zbatimin e metodologjisë së VNMDHP, • ndihmon në vlerësimin e rrezikut, • ndihmon në rritjen e ndërgjegjësimit të pjesëmarrësit në VNMDHP për parimet, përkufizimet, rregullat dhe detyrimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

Rastet kur VNMDHP nuk është e detyrueshme

Sipas nenit 5 paragrafi i Rregullores për procesin e vlerësimit të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale, nga Agjencia për MTP, VNMDHP është jo e detyrueshme në rastet e mëposhtme kur:

- operacionet e përpunimit për të cilat Kontrolluesi ka vlerësuar se nuk ka mundësi të rezultojnë në rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e personave fizik;
- natyra, vëllimi, konteksti dhe qëllimet e përpunimit janë të ngjashme me përpunimin për të cilin është zbatuar VNMDHP; dhe
- përpunimi përfshihet në Listën e llojeve të operacioneve të përpunimit për të cilat nuk kërkohet VNMDHP e përcaktuar nga Agjencia.

Kontrolluesi duhet të justifikojë dhe dokumentojë arsyet e moszbatimit të VNMDHP, duke përmendur mendimin e Oficerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim: oficeri)

2. Rolet dhe përgjegjësitë

Në procesin e zbatimit të VNMDHP përfshihen pjesëmarrësit e mëposhtëm:

Kontrolluesi -Kontrolluesi është plotësisht përgjegjës për zbatimin e VNMDHP dhe ai përcakton personat përgjegjës për zbatimin e VNMDHP.

Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale - Kontrolluesi kërkon këshillë nga oficeri, atje ku është caktuar, gjatë procesit të kryerjes së Vlerësimit. Këshillat dhe vendimet e oficerit dokumentohen në kuadër të VNMDHP.

Përpunues - Kur përpunimi do të kryhet plotësisht ose pjesërisht nga përpunuesi, atëherë përpunuesi është i detyruar të ndihmojë kontrolluesin në zbatimin e VNMDHP, ku rolet, detyrimet dhe përgjegjësitë e kontrolluesit dhe përpunuesit përcaktohen domosdoshmërisht me marrëveshje në përputhje me rregulloret për mbrojtjen e të dhënave personale.

Persona të tjerë të përfshirë në përpunimin e të dhënave personale - Kjo përfshin personat përgjegjës nga sektorë të ndryshëm brenda kompanisë ose menaxherët e projektit të cilët duhet të konsultohen për të mbledhur të dhëna relevante për përpunimin e të dhënave personale.

3. Rastet në të cilat zbatimi i VNMDHP është i detyrueshëm

Në bazë të listës së operacioneve për të cilat kërkohet VNMDHP, në përputhje me nenin 39 (paragrafi 4) të VNMDHP dhe nenin 3 të *Rregullores për Vlerësimin e Ndikimit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale*, përcaktohen operacionet e përpunimit për të cilat kërkohet vlerësim.

Për të përcaktuar se cilat operacione do të rezultojnë me rrezik të lartë, merren parasysh kriteret e në vijim:

- Vlerësimi ose pikëzimi, duke përfshirë profilizimin dhe parashikimin, veçanërisht bazuar në aspekte që lidhen me funksionimin e subjektit të të dhënave personale, situatën ekonomike, shëndetin, preferencat ose interesat personale, sigurinë ose sjelljen, vendndodhjen ose lëvizjet.
- Vendimmarrje automatike me efekt juridik ose të ngjashëm substancial, gjegjësisht përpunim që synon marrjen e vendimeve në lidhje me subjektet e të dhënave personale që prodhojnë pasoja juridike për subjektin fizik ose në mënyrë të ngjashme ndikojnë ndjeshëm në subjektin fizik. Për shembull, përpunimi mund të rezultojë me përjashtim ose diskriminimin e individëve. Përpunimi që ka pak ose aspak ndikim tek individët nuk e plotëson këtë kriter.
- Monitorimi sistematik, gjegjësisht përpunimi që përdoret për monitorimin, ndjekjen ose kontrollin e subjekteve të të dhënave personale, përfshirë të dhënat e mbledhura përmes rrjeteve ose “vëzhgimi sistematik i hapësirave të disponueshme për publikun”. Ky lloj vëzhgimi është një nga kriteret sepse të dhënat personale mund të mbledhen në situata kur subjektet e të dhënave personale nuk janë të vetëdijshëm se kush i mbledh të dhënat e tyre dhe për çfarë qëllimesh do të përdoren. Përveç kësaj, individët mund të mos jenë në gjendje të shmangin një përpunim të tillë në vende publike (ose të disponueshme publikisht).

- Të dhëna të ndjeshme ose të dhëna të natyrës shprehimisht personale: kjo përfshin kategori të veçanta të të dhënave personale që përcaktohen në nenin 4 paragrafi (1) pika 13 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe të dhëna personale në lidhje me dënime penale dhe vepra penale.
- Përpunim i gjerë i të dhënave. Gjatë përcaktimit nëse përpunimi është i gjerë sipas rrethanave të secilit rast konkret, merren parasysh faktorët e mëposhtëm:
 - numri i subjekteve të të dhënave personale të prekur, qoftë një numër konkret apo përqindje e popullsisë përkatëse;
 - vëllimi i të dhënave dhe/ose përfshirje e llojeve të ndryshme të të dhënave që përpunohen;
 - kohëzgjatjen ose vazhdimësinë e operacioneve të përpunimit të të dhënave personale;
 - fushëveprimin gjeografik të aktiviteteve të përpunimit të të dhënave personale.
- Grup të dhënash personale që përputhen ose kombinohen, për shembull ato që burojnë nga dy ose më shumë operacione të përpunimit të të dhënave personale që janë kryer për qëllime të ndryshme dhe/ose nga kontrollues të ndryshëm në mënyrë që tejkalon pritshmëritë e arsyeshme të subjektit të të dhënave personale.
- Të dhënat në lidhje me subjektet e cenueshme të të dhënave personale: përpunimi i këtij lloji të të dhënave është kriter për shkak të rritjes së mosbalancimit të fuqisë midis subjekteve të të dhënave personale dhe kontrolluesve, ku individët nuk mund thjesht të japin pëlqimin ose të kundërshtojnë përpunimin e të dhënave të tyre ose të ushtrojnë të drejtat e tyre. Subjektet e cenueshme të të dhënave personale janë fëmijët (vlerësohet se ata nuk mund të bien dakord ose kundërshtojnë me vetëdije dhe qëllim përpunimin e të dhënave të tyre personale), punonjësit, grupet më të cenueshme që kanë nevojë për mbrojtje të veçantë (personat me aftësi të kufizuara mendore, azilkërkuesit ose personat e moshuar, pacientët, etj.), si dhe raste të tjera kur ka një çekuilibër në pozicionin e subjektit të të dhënave personale dhe kontrolluesit.
- Përdorimi inovativ ose aplikimi i zgjidhjeve të reja teknologjike ose organizative, siç janë kombinimi i përdorimit të shenjave të gishtërinjve dhe njohjes së fytyrës për të përmirësuar kontrollin fizik të qasjes, etj.
- Situatat kur përpunimi mund të parandalojë subjektet e të dhënave personale nga ushtrimi i të drejtave të caktuara ose përdorimi i një shërbimi ose kontrate. Kjo përfshin procedurat e përpunimit që duhet të mundësojnë, ndryshojnë ose refuzojnë qasjen e subjekteve të të dhënave personale në një shërbim të caktuar ose lidhjen e kontratës.

4. Rastet në të cilat nuk është e detyrueshme kryerja e VNMDHP

Në bazë të listës së operacioneve për të cilat kërkohet VNMDHP, në përputhje me nenin 39 (paragrafi 5) të VNMDHP dhe nenin 5 të *Rregullores për Vlerësimin e Ndikimit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale*, përcaktohen operacionet e përpunimit për të cilat kërkohet vlerësim.

Në përputhje me pikën 1 të kësaj liste, nuk kërkohet vlerësim i ndikimit në mbrojtjen e të dhënave personale për lloje të caktuara të operacioneve të përpunimit, veçanërisht kur:

- operacionet e përpunimit nuk rezultojnë në rrezik të lartë për të drejtat dhe liritë e personave fizik;
- proceset (operacionet) paraprakisht janë përcaktuar se nuk janë ekspozuar në rrezik gjatë vlerësimit të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave personale; - përpunimi veç më është miratuar nga Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- për përpunimin veç më ekziston një bazë ligjore ekzistuese e qartë dhe specifike në sistemin ligjor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe kur Vlerësimi i Ndikimit në mbrojtjen e të dhënave personale tashmë është kryer si pjesë e krijimit të asaj baze ligjore sipas nenit 10 paragrafi (3) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- kryhet si pjesë e Vlerësimit të Ndikimit që rrjedh nga baza e interesit publik dhe kur Vlerësimi i Ndikimit në Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka qenë element i atij vlerësimi sipas nenit 10 paragrafi (3) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale; dhe/ose
- Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale do të vendosë të përfshijë përpunime të caktuara si operacion për përpunim në përputhje me nenin 39 paragrafi (5) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në përputhje me *Rregulloren për procesin e vlerësimit të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale, ne, si kontrollues*, detyrimisht i justifikojmë dhe dokumentojmë arsyet e moszbatimit të VNMDHP, duke shprehur edhe mendimin e Oficerit për Mbrojtjen e të Dhënave personale.

5. Procesi i kryerjes së vlerësimit të ndikimit në mbrojtjen e të dhënave personale

Vlerësimi i ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale kryhet sipas fazave dhe hapave të mëposhtëm:

Përshkrim i hollësishëm i fazave dhe hapave të procesit për kryerjen e VNMDHP

Faza 1 – Konsultimi i procesverbalit (evidentimit) të operacioneve të përpunimit dhe përgatitja e vlerësimit fillestar

Në evidentimin e operacioneve të përpunimit të të dhënave personale (dokumenti ROPA) evidentohen të gjitha përpunimet e të dhënave personale që kryhen në kompaninë tonë me informacion të detajuar për çdo përpunim që mbulon pikat e mëposhtme:

- Përcaktimin e natyrës, vëllimit, kontekstit dhe qëllimeve të përpunimit;
- Evidentimi i llojit të të dhënave personale, marrësit dhe periudhën e ruajtjes së të dhënave personale;
- Përshkrimi i operacionit të përpunimit;
- Identifikimi i mjeteve nga të cilat varen të dhënat personale (pajisjet, programet softuerike, rrjetet, personat, dokumentet në formë letrash ose kanalet për dërgimin e dokumenteve në formë letrash);
- Përcaktimin e qëllimeve të përpunimit;
- Përcaktimin e bazës ligjore për përpunimin;

Sipas kritereve të përfshira në listën e rasteve për të cilat VNMDHP është e detyrueshme, bëhet një vlerësim fillestar për operacionet e përpunimit, të cilat janë të përmendura në dokumentin ROPA.

Vlerësimi fillestar bëhet në përputhje me dokumentin në kuadër të kësaj Metodologjie –**Shtojca 1:** Formulari për kryerjen e vlerësimit fillestar

Nëse përcaktohet se për ndonjë nga operacionet e përpunimit të përmendura vlerësimi është i detyrueshëm, në atë rast kalohet në fazën e dytë të procesit – **Vlerësimi i plotë**.

Shënim: Vlerësim fillestar kryhet për secilën nga aktivitetet e procesit të përmendura që gjenden në evidencë.

Nëse evidenca përmban x përpunim të të dhënave personale, atëherë do të bëhen vlerësimet fillestare.

Faza 2 – Vlerësimi i plotë

Faza e dytë e procesit për kryerjen e VNMDHP fillon me një analizë të detajuar të operacionit që u identifikua në vlerësimin fillestar.

Hapi 1: Identifikohet nevoja për të kryer Vlerësimin – pse ekziston nevoja për vlerësim dhe çfarë lloj përpunimi përfshin Vlerësimi.

Hapi 2: Përshkruhet lloji i përpunimit (si mbledhen, ruhen dhe fshihen të dhënat), kontekstin, vëllimin dhe qëllimet e përpunimit.

Hapi 3: Konsultimet – identifikoni të gjithë pjesëmarrësit që do të konsultohen dhe prej të cilëve do të kërkohet mendim në Vlerësimin. Identifikohet nëse duhet të përfshihen përpunuesit ose ekspertë të tjerë të jashtëm.

Hapi 4: Përshkruhet domosdoshmëria dhe korniza ligjore për kryerjen e vlerësimit.

Faza 3: Identifikimi i rrezikut

Në këtë fazë, identifikohen rreziqet e mundshme që mund të kenë ndikim në subjektet e të dhënave personale.

Kjo fazë identifikon burimin, natyrën, veçorinë dhe seriozitetin e rrezikut, në mënyrë më të detajuar për çdo rrezik (qasje të paautorizuar, ndryshime të padëshiruara dhe të dhëna të humbura) pikën e subjekteve të të dhënave personale.

Për çdo operacion, identifikohet **një listë e rreziqeve** për të drejtat dhe liritë e personit fizik dhe bëhet vlerësim i rrezikut ku shënohet niveli i ndikimit, gjegjësisht shkalla e rrezikut.

Identifikohen 4 shkallë ndikimi:

- **E ulët**, kur personat fizik mund të përballen me disa shqetësime të vogla, të cilat do t'i kapërcejnë pa problem (për shembull: koha e humbur për të rifutur të dhënat, shqetësim, acarimi, etj.)

- **I mesëm**, kur personat fizik mund të përballen me shqetësime të konsiderueshme, të cilat do të mund t'i kapërcejnë pavarësisht vështirësive të caktuara, (për shembull: kostot shtesë, refuzimi i qasjes në shërbime të caktuara afariste, frika, mungesa e të kuptuarit, stresi, sëmundjet e vogla fizike, etj.)

- **I lartë**, kur personat fizik mund të përballen me pasoja të konsiderueshme, të cilat do duhej t'i kapërcejnë, por me vështirësi serioze, (për shembull: përvetësim i kundërligjshëm i mjeteve, futja në listën e zezë nga institucionet financiare, dëmtimi i pronës, humbja e punësimit, thirrja në gjyq, përkeqësimi i shëndetit, etj.)

- **Shumë i lartë**, kur personat fizik mund të përballen me pasoja të konsiderueshme, madje të pakthyeshme, të cilat nuk do mund t'i kapërcejnë (për shembull: paaftësia për të punuar, sëmundjet psikologjike ose fizike afatgjata, vdekja, etj.).

Në analizën e rrezikut, zbatohet formula e mëposhtme:

Rreziku = (gjasat e ndodhjes së kërcënimit) x (shkalla e ndikimit)

Rreziku shprehet si funksion i mundësisë së ndodhjes së kërcënimit (rezultati i padëshiruar) dhe ndikimi (pasoja) e rezultatit të padëshiruar nëse ndodh

Niveli i rrezikut mund të përcaktohet sipas tabelës së mëposhtme:

		Ndikimi			
		I ulët	I mesëm	I lartë	shumë i lartë
P r o b a b i l i t eti	Shumë i mundur	Rrezik i mesëm	Rrezik i lartë	Rrezik shumë i lartë	Rrezik shumë i lartë
	I mundur	Rrezik i ulët	Rrezik i mesëm	Rrezik i lartë	Rrezik shumë i lartë
	I vogël	Rrezik i ulët	Rrezik i ulët	Rrezik i mesëm	Rrezik i lartë
	Shumë I vogël	Rrezik i ulët	Rrezik i ulët	Rrezik i ulët	Rrezik i mesëm

Sipas kësaj tablele të vlerësimit të rrezikut, mund të identifikohen tre nivele rreziku:

- I ulët
- I mesëm
- I lartë

Pas mbledhjes së këtyre informacioneve për çdo operacion që kërkon vlerësim, vkalohet në Fazën e 3 – Menaxhimi i rrezikut.

Faza 3 – Menaxhimi i rrezikut

Në këtë fazë definoen masat që do të zbatohen për të zbutur rreziqet ndaj të drejtave dhe lirive të subjektit.

Analizohen informacionet nga Faza 2 dhe konsultohet Rregullorja për Masat Teknike dhe Organizative për Sigurinë e të Dhënave Personale me qëllim verifikimin e masave teknike dhe organizative të aplikuara për mbrojtjen e të dhënave personale brenda organizatës.

Identifikohen dobësitë dhe miratohen rekomandimet dhe masat e duhura që duhet të zbatohen për të zvogëluar ndikimin dhe për të zbutur rrezikun tek subjektet.

Faza 4 – Raporti për VNMDHP-në e zbatuar

Bazuar në gjetjet, informacioneve dhe analizën e rrezikut të fazave të mëparshme, përgatitet raport përfundimtar i vlerësimit që përmban të dhëna dhe detaje të vlerësimit.

Raporti për vlerësimin e kryer plotësohet në kuadër të formularit të kësaj Metodologjie: **Shtojca 2 – Raporti për VNMDHP-në e kryer.**

Kinoteka do të demonstrojë respektimin e parimin e llogaridhënies dhe transparencës dhe ta dorëzojë raportin e VNMDHP-së së zbatuar me kërkesë të Agjencisë.

6. Vlerësimi

VNMDHP duhet të rishikohet pas ndryshimit të rreziqeve që rrjedhin nga operacionet e përpunimit (p.sh. përdorimi i teknologjisë së re, kur të dhënat personale përdoren për qëllime tjera, etj.).

Nëse ndryshime të caktuara zvogëlojnë rrezikun, në situata të tilla, rishqyrtimi i analizës së bërë të rrezikut mund të tregojë se kontrolluesi nuk ka nevojë të kryejë VNMDHP.

Dispozitat përfundimtare

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit.

Rregullorja i nënshtrohet kontrolleve dhe përditësimeve të rregullta në përputhje me ndryshimet në strukturën organizative, infrastrukturën teknike ose kërkesat e reja ligjore dhe /ose rregullatore.

Nr. _____

Data:

IK Kinoteka e Republikës së Maqedonisë së Veriut
-Kryetari i Bordit Drejtues

Tomisllav Osmanli

Shprehje dhe përkufizime relevante

Shprehjet	Përkufizimi
VNMDHP	Vlerësimi i ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale – operacion që kryhet me qëllim të identifikimit në kohë të të gjitha rreziqeve të mundshme që mund të lindin nga operacion i caktuar në të cilin përpunohen kategori të ndjeshme të të dhënave personale. Është e detyrueshme të zbatohet sipas Rregullores për procesin e vlerësimit të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale, nga Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
Metodologjia e VNMDHP	Dokumenti që duhet të miratohet në mënyrë të detyrueshme nga kontrolluesi për të përcaktuar qasjen metodologjike që do të përdoret te kontrolluesi për kryerjen e Vlerësimit. Metodologjia është e detyrueshme, sipas nenit 10 të Rregullores për VNMDHP.
Rastet në të cilat VNMDHP është e detyrueshme	Kriter në bazë të cilit përcaktohet se cilat operacione të përpunimit mund të rezultojnë në rrezik të lartë. Lista e rasteve për të cilat kërkohet VNMDHP - sipas nenit 39 (paragrafi 4) të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe nenit 3 të Rregullores për Vlerësimin e Ndikimit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale.
Rastet në të cilat VNMDHP nuk është e detyrueshme	Lista e rasteve për të cilat nuk është e detyrueshme të kryhet vlerësim i ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale – sipas nenit 39 (paragrafi 5) të Ligjit për Mbrojtjen e të dhënave personale dhe nenit 5 të Rregullores për Procesin e Vlerësimit të ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale.
Kontrollues	Kontrollues është person fizik ose juridik, organ i pushtetit qendror, organ shtetëror ose person juridik i themeluar nga shteti për të ushtruar kompetenca publike, agjenci ose organ tjetër, i cili në mënyrë të pavarur ose së bashku me të tjerët përcakton qëllimet dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale dhe kur qëllimet dhe mënyra e përpunimit të të dhënave personale përcaktohen me ligj, me të njëjtin ligj përcaktohen kontrolluesi ose kriteret e veçanta për përcaktimin e tij;
Përpunues	Përpunues i përmbledhjes së të dhënave personale është personi fizik ose juridik, organ i pushtetit qendror, organ shtetëror ose person juridik i themeluar nga shteti për të ushtruar autoritet publik, agjenci ose organ tjetër që përpunon të dhënat personale në emër të kontrolluesit;
Personi që kryen vlerësim	Personi i kualifikuar i jashtëm ose i brendshëm i caktuar nga Kontrolluesi për të kryer Vlerësimin e Ndikimit në Mbrojtje e të dhënave personale
Analiza e rrezikut	Analizë e detajuar e rreziqeve për të drejtat dhe liritë e subjekteve

7. Shtojca 1 - Vlerësimi fillestar i ndikimit të mbrojtjes së të dhënave personale

Përpunimi: *Emri i Përpunimit*

Personi përgjegjës për kryerjen e vlerësimit: *Emri, mbiemri, funksioni*

Data e kryerjes së vlerësimit:

Kriteri	Përmbushur (Po/Jo)
1. Vlerësimi, profilizimi dhe parashikimi, veçanërisht bazuar në aspekte që lidhen me: ● punën e subjektit të të dhënave personale, ● gjendjen ekonomike, ● shëndetësore, ● preferencat ose interesat personale, ● siguria ose sjellja, ● vendndodhja ose lëvizjet	
2. Vendimmarrja automatike me veprim juridik ose veprim material të ngjashëm. Për shembull, nëse përpunimi rezulton me përjashtim ose diskriminim. Përpunimi me ndikim të vogël ose pa ndikim te individët nuk e plotëson këtë kriter.	
3. Monitorim sistematik, gjegjësisht përpunim që përdoret për: ● monitorimin, ndjekje ose kontrollin e subjekteve të të dhënave personale, duke përfshirë edhe ● të dhënat e mbledhura përmes rrjeteve ose “vëzhgimi sistematik i hapësirave të disponueshme publike” – kur të dhënat personale mblidhen në situata kur subjektet DHP nuk janë në dijeni se kush i mbledh të dhënat e tyre dhe për çfarë qëllimesh do të përdoren.	
4. Të dhëna personale të ndjeshme me natyrë personale të theksuar: kategori të veçanta të DHP neni. 4 paragrafi. (1) pika 13 e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale: ● origjina racore ose etnike, ● pikëpamjet politike, ● bindjet fetare ose filozofike ● anëtarësimi në organizata sindikale ● të dhëna gjenetike, ● të dhënat biometrike, ● të dhëna për shëndetin ose ● të dhëna për jetën seksuale ose orientimin seksual, si dhe DHP në lidhje me ● dënimet penale dhe veprat penale	
5. Përpunim i gjerë i të dhënave. Gjatë përcaktimit të gjerësisë, merren parasysh faktorët e mëposhtëm:	

● numri i subjekteve të prekura të të dhënave personale, gjegjësisht numri ose përqindja e popullsisë relevante; ● vëllimi i të dhënave dhe/ose përfshirja e llojeve të ndryshme të të dhënave që përpunohen; - kohëzgjatja ose vazhdimësia e operacioneve të përpunimit të të dhënave personale; - fushëveprimi gjeografik i aktiviteteve të përpunimit të të dhënave personale.	
6. Grup i të dhënave personale që përputhen ose kombinohen, për shembull, që rrjedhin nga më shumë përpunime operacionale i të dhënave personale, <i>për qëllime të ndryshme</i> nga kontrollues të ndryshëm në një mënyrë që tejkalon pritshmëritë e arsyeshme të subjektit DHP.	
7. Të dhënat në lidhje me subjektet e cënueshme të të dhënave personale: ky lloj përpunimi është kriter për shkak të rritjes së mosbalancimit të fuqisë midis subjekteve të DHP dhe kontrolluesve, ku personat fizikë thjesht nuk mund të dakordohen ose të kundërshtojnë përpunimin e të dhënave të tyre ose të ushtrojnë të drejtat e tyre. Subjektet e cënueshme të të dhënave personale janë: ● fëmijët (ata nuk mund të pranojnë me vetëdije dhe me qëllim të kundërshtojnë përpunimin e të dhënave të tyre personale), ● punonjësit, ● grupe më të cënueshme për të cilat duhet mbrojtje e veçantë (personat me aftësi të kufizuara mendore, azilkërkuesit, të moshuarit, pacientët, etj.), gjegjësisht kur ka një çekuilibër në pozicionin e subjektit të të DHP dhe kontrolluesit.	
8. Përdorimi inovativ ose aplikimi i zgjidhjeve të reja teknologjike ose organizative, siç janë: ● kombinimi i shenjave të gishtërinjve dhe ● njohja e fytyrës për të përmirësuar kontrollin e qasjes fizike, etj.	
9. Situatat kur përpunimi mund të parandalojë subjektet e të dhënave personale nga ushtrimi i të drejtave të caktuara ose përdorimi i një shërbimi ose kontrate. Kjo përfshin procedura për përpunim që duhet të mundësojnë, ndryshojnë ose refuzojnë qasjen e subjekteve të të dhënave personale në një shërbim të caktuar ose lidhjen e kontratës.	

8. Shtojca 2 - Zbatimi i VNMDHP

Faza 1: Përkufizimi i kontekstit të përpunimit

Hapi 1: Identifikimi i nevojës për të bërë VNMDHP të plotë
<i>Të shënohet cili kriter është plotësuar dhe identifikuar si nevojë për kryerjen e vlerësimit</i>
Hapi 2: Përshkrimi i përpunimit të të dhënave personale
Konteksti i përpunimit: Cila është marrëdhënia midis kontrolluesit dhe subjektit? A janë përfshirë në përpunim fëmijë ose kategoritë e tjera të cenueshme subjektesh? A janë të njoftuar subjektet se si do të përdoren të dhënat e tyre?
Përshkrimi i qëllimit të përpunimit: <i>Qëllimi i përpunimit është:</i>
Përshkrimi i gjerësisë së përpunimit: <i>Për këtë aktivitet ka përpunim të kategorive të mëposhtme të të dhënave personale:</i> <i>- Të numërohen</i> <i>Nuk ka/Ka përpunim të kategorive të veçanta të të dhënave personale ose të dhëna personale që lidhen me dënimet për vepra penale.</i>
Përshkrimi i mënyrës së përpunimit: <i>- Si mbledhen, ruhen dhe fshihen të dhënat</i> <i>- Mënyra dhe mjetet për përpunimin e të dhënave (pajisjet e përdorura, rrjetet, burimet njerëzore)</i> <i>- A ndahen të dhënat personale me palë të treta</i> <i>- Afati i ruajtjes</i>
Hapi 3: Konsultimi me pjesëmarrësit e tjerë në procesin e përpunimit
<i>- A do të kërkohet gjatë përpunimit mendim nga palët tjera të prekura ose ekspertët</i>
Hapi 4: Përshkrimi i domosdoshmërisë dhe kornizës ligjore për procedimin

Faza 2: Identifikimi i rreziqut

Në këtë fazë të zbatimit të VNMDHP-së, bëhet analiza dhe vlerësimi i rreziqeve për të drejtat dhe liritë e personave fizik dhe metodologjia e analizimit të rreziqeve për të drejtat dhe liritë e personave fizik, në përputhje me matricën e Vlerësimit të Rreziqut nga faqja 10 e kësaj Rregullore.

Përshkrimi i burimit të rrezikut dhe ndikimit të mundshëm ndaj subjekteve	Mundësia	Ndikimi	Niveli i rrezikut
1. Rrezik: Shembull: Qasje e paautorizuar në të dhëna Ndikimi: Pasoja e mundshme ndaj subjekt: vështirësi në marrjen e angazhimit profesional, ulje e reputacionit	I mesëm	I lartë	I lartë
2. Rrezik: Shembull: Humbja e të dhënave Fshirja e qëllimshme ose e paqëllimshme e të dhënave ose humbja e dokumenteve në formë letrë Ndikimi: Mund të shkaktojë shqetësim për subjektin për shkak të mundësisë së qasjes në të dhëna nga palët e treta dhe pamundësisë për të rikthyer të dhënat.	I mesëm	I mesëm	I mesëm
3.			

Faza 3: Identifikimi i masave të menaxhimit të rrezikut

Rrezik	Masat për zbutjen e rrezikut	Efekti i rrezikut (I eliminuar, zvogëluar ose i pranueshëm)	A është zbatuar masa Po / Jo	Rreziku i mbetur pas masës së zbatuar (i ulët, i mesëm ose i lartë)
P.sh. Rrjedhja e të dhënave				
P.sh. Ndryshim i paautorizuar i të dhënave				

Masat për zbutjen e rrezikut zbatohen vetëm për rreziqet e identifikuar për të cilat është vërtetuar se janë me rrezik të mesëm ose të lartë.

Faza 4: Regjistri i vlerësimit të kryer

Raport mbi ndikimin e vlerësuar në mbrojtjen e të dhënave personale	
Përshkrimi i procesit të përpunimit	<< Të përmbledhen >>
Personat e brendshëm ose të jashtëm të përfshirë në procesin e VNMDHP	<< Të përmbledhen >>
Analiza e rreziqeve	<< Të përmbledhen >>
Masat e menaxhimit të rrezikut	<< Të përmbledhen >>
Konkluzat e pronarit të të dhënave	<< Të përmbledhen >>
Mendimi i ZMDHP	<< Të kërkohej nga Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave personale >>
Plani i veprimit	<< Të shënohet nëse ka nevojë. Përndryshe në mënyrë eksplicite të shënohet se nuk ka plan veprimi. >>
Aprovuar nga:	